



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 129

Tiranë – E premte, 9 qershor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 798/3, datë 8.6.2017	Për delegim kompetence..... 6521
Udhëzim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 4557/1, datë 1.6.2017	Për regjistrimin e titujve në shoqërinë Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a., Tiranë..... 6521
Udhëzim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 1, datë 31.5.2017	Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore..... 6521
Udhëzim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 2, datë 1.6.2017	Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiarë..... 6523
Udhëzim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 3, datë 2.6.2017	Për mënyrën e përlogaritjes së kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore.. 6525
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 3350, datë 1.6.2017	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Shtimi i sipërfaqes së varrezave publike Tufinë”, Tiranë..... 6527
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 906/6, datë 6.6.2017	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim dhe ndriçim, Rruga e Malit, Rruga Kalaja” në bashkinë Krujë..... 6528

**VENDIM****Nr. 798/3, datë 8.6.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në bazë të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

VENDOSA:

1. Ndërprerjen e delegimit të kompetencave që më jep ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara në nenet 8 pikat 6; 9 pikat 4 dhe 5 dhe 10 pika 10 të tij, të deleguara zotit Alban Brati, Drejtor i Shërbimit Juridik me vendimin nr. 798 Prot., datë 3.3.2017, për arsye të largimit të tij me shërbim jashtë vendit, për nevoja pune, shërbim i planifikuar kohë më parë.

2. Delegimin e kompetencave që më jep ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara në nenet 8 pikat 6; 9 pikat 4 dhe 5 dhe 10 pika 10 të tij, zonjës Marsjola Duro, Drejtor i Përgjithshëm i Informacionit dhe Dokumentacionit, për arsye të kandidimit tim në organet e rivlerësimit sipas ligjit të sipërpërmendur.

3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 12 qershor 2017 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Albana Shtylla

UDHËZIM**Nr. 4557/1, datë 1.6.2017**

**PËR REGJISTRIMIN E TITUJVE
NË SHOQËRINË “QENDRA E
REGJISTRIMIT TË AKSIONEVE”
SH.A., TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 119, pika 5, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të neneve 6 e 13 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”,

UDHËZOJ:

1. Shoqëritë aksionare, të cilat rezultojnë të regjistruara në regjistrin tregtar, në rastet e ndryshimeve në lidhje me transferimin e aksioneve,

kapitalin e regjistruar, numrin e aksioneve dhe/ose vlerën nominale të secilit aksion, kanë detyrimin e pasqyrimin të këtyre ndryshimeve në shoqërinë Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a., Tiranë.

2. “Titull”, sipas formës juridike, janë ato të përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”.

3. Detyrimi për regjistrimin e titujve (aksioneve) në shoqërinë Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a., Tiranë, rrjedh nga pika 5 e nenit 119 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a., Tiranë dhe Shoqëritë aksionare të regjistruara në Regjistrin Tregtar.

5. Udhëzimi nr. 309, datë 3.6.2014, “Për regjistrimin e titujve në shoqërinë Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a.”, Tiranë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

UDHËZIM**Nr. 1, datë 31.5.2017**

**PËR PËRDORIMIN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE DHE VENDET
PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË
FUSHATËS ZGJEDHORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 3, pika 5, nenit 77, pika 1, nenit 78, pika 1, nenit 79 dhe nenit 88 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” neni 24/2, pika 4 dhe 5 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, me ligjin nr. 90/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar”,



UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë kufizimet në përdorimin e materialeve propagandistike statike dhe vendndodhjet e lejuara për afishimin e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Neni 2
Materialet propagandistike statike

1. Materiale propagandistike statike janë të gjitha materialet që i shërbejnë subjektit elektoral për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë të instaluar apo të ngjitura në mjediset publike ose në mjedise me akses për publikun, si në shtyllat e ndriçimit, fasadat e ndërtesave, shesheve, vitrinat e njësisve ose objekteve, përgjatë rrugëve jashtëqytetase etj. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor. Përdorimi i materialeve propagandistike statike, jashtë parashikimit të fjalisë së dytë të kësaj pike është i ndaluar.

2. Subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat.

3. Subjekti zgjedhor është i detyruar që brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi të njoftojë me shkrim Kryetarin e bashkisë përkatëse, adresat e sakta të zyrave elektorale. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, administrata e bashkisë bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike.

4. Bashkia, nëpërmjet organeve të zbatimit të ligjit në varësi të saj, është e detyruar të heqë të gjitha materialet propagandistike që janë afishuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

5. Çdo shpenzim për materiale propagandistike statike i kryer nga subjektet zgjedhore jashtë kushteve dhe kriterëve të këtij udhëzimi do të konsiderohet nga KQZ-ja si shpenzim në kundërshtim me pikën 4 të nenit 24/2 të ligjit nr. 90/2017.

Neni 3

Materialet propagandistike lëvizëse

1. Materialet propagandistike lëvizëse janë të gjitha ato materiale që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës së vet dhe që janë të instaluar në mjete lëvizëse, shfaqen ose shpërndahen në tubimet elektorale të subjektit, ose që shpërndahen te zgjedhësit, në kuadër të veprimtarive dhe promovimit të fushatës zgjedhore. Ky udhëzim nuk prek përdorimin e materialeve propagandistike lëvizëse nga ana e subjektit zgjedhor.

Neni 4
Materialet edukative

1. Kryetarët e bashkive janë të detyruar që të caktojnë vende të posaçme publike për afishimin e materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ-së, ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor, por që i shërbejnë edukimit të zgjedhësve, lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe të votimit sipas Kodit Zgjedhor. Në vendafishimet e përcaktuara sipas këtij neni, subjektet zgjedhore lejohet të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.

2. Vendi i afishimit të materialeve edukative dhe informuese duhet të ketë pozicion qendror dhe akses të lartë për publikun dhe hapësirë të bollshme për të gjitha materialet edukative.

Neni 5
E drejta e ankimit

1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimit për heqjen e materialeve propagandistike statike, sipas pikës 4 të nenit 2 të këtij udhëzimi në KQZ. KQZ-ja merr vendim brenda 24 orëve nga paraqitja e ankimit.

2. KQZ-ja, kur vihet në dijeni për shkelje të këtij udhëzimi nga ana e subjektit zgjedhor, urdhëron Kryetarin e bashkisë për heqjen e materialeve të afishuara në kundërshtim me dispozitat e këtij udhëzimi. Kryetari i bashkisë është i detyruar të raportojë brenda 24 orëve, për zbatimin e urdhërimit të KQZ-së.



Neni 6
Sanksionet

Në rastet e kundërvajtjeve administrative, KQZ-ja vendos sanksionet administrative të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

Neni 7
Shfuqizimet

Udhëzimi nr. 14, datë 24.4.2009, “Për kriteret për zgjedhjen e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike në fushatën zgjedhore” shfuqizohet.

Neni 8

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Klement Zguri

UDHËZIM
Nr. 2, datë 1.6.2017

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE
DHE KRITEREVE PËR
PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E
EKSPERTËVE FINANCIARË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, neni 23, pika 1, germa “b”, nenit 24/4 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar”,

UDHËZON

PJESA I
TË PËRGGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiarë për monitorimin në mënyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale të fushatës zgjedhore në përputhje me kreun II, pjesa II, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, dhe standardet

ndërkombëtare të kontabilitetit të parashikuara në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Ekspertët financiarë që emërohen për monitorimin e fushatës zgjedhore duhet të disponojnë njohuri të certifikuara në fushën e auditimit financiar dhe të kenë eksperiencë profesionale në fushën e ekspertizës së llogarive si dhe të disponojnë referenca që dëshmojnë profesionalizimin dhe paanësinë.

2. Monitorimi nga ekspertët financiarë bëhet në emër dhe për llogari të KQZ-së dhe synon vlerësimin për shkallën e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve zgjedhore me kushtet dhe kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, për financimin dhe raportimin e shpenzimeve të fondit financiar, përfituar nga partia politike gjatë fushatës. Monitorimi i fushatës zgjedhore bëhet me anë të vëzhgimit dhe grumbullimit të informacionit për veprimtari të përzgjedhura statistikisht.

3. Përzgjedhja dhe emërimi i ekspertëve financiarë bëhet në bazë të parimit të konkurrimit të lirë dhe të barabartë dhe garancisë për mungesën e konfliktit të interesave.

4. Shpërblimi për veprimtarinë e monitorimit bëhet sipas tarifave të përcaktuara në kontratën e shërbimit sipas kontratës tip të miratuar me vendim të KQZ-së dhe orientohet nga tarifat e tregut.

Neni 3
Kërkesa të veçanta

Ekspertët financiarë të emëruar sipas këtij udhëzimi duhet të monitorojnë në mënyrë specifike:

a) Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;

b) Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;

c) Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit,



sidomos për sa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;

d) Kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruar nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;

e) Rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;

f) Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

Neni 4 Aplikimi

1. KQZ-ja, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, publikon njoftimin për aplikimin e personave të interesuar për emërimin si ekspert financiar për monitorimin e pasqyrimin të fushatës zgjedhore.

2. Të interesuarit, përveç kushteve të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e ekspertëve financiarë, duhet të paraqesin pranë KQZ-së dhe dokumentacionin, si më poshtë:

a) Kërkesën për t'u përfshirë në procesin e monitorimit;

b) Dëshmitë që provojnë aftësimin profesional, përfshirë dëshmitë e kualifikimit dhe licencat apo autorizimet për ushtrimin e profesionit;

c) Referenca të punëve të mëparshme profesionale;

d) Kopje të dokumentit të identifikimit;

e) Deklaratë vetjake nëse është në kushtet e konfliktit me ndonjë nga subjektet zgjedhore që do të monitorohen, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

Neni 5 Verifikimi paraprak

1. KQZ-ja, brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, sipas neni 4 të këtij udhëzimi, në bazë të dokumentacionit të depozituar, mund të bëjë seleksionimin paraprak të aplikantëve nëse konstaton se aplikantë të veçantë ndodhen

në kushtet e konfliktit të interesit, që cenojnë integritetin e monitorimit, nuk japin referenca të mjaftueshme që të dëshmojnë profesionalizëm dhe paanësi, ose nuk u janë përgjigjur në mënyrë të kënaqshme zbatimit të kontratave të mëparshme me KQZ-në.

2. Kundër vendimit të KQZ-së, për miratimin e listës paraprake, personat e skualifikuar nga lista e përzgjedhur mund të ankimohen në KQZ jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

3. KQZ-ja miraton listën e personave të cilët do të marrin pjesë në shortin për emërimin si ekspertë financiarë, të cilët do të monitorojnë fushatën zgjedhore, jo më vonë se 45 ditë para datës së zgjedhjeve.

Neni 6 Procedura e emërimit

1. KQZ-ja përcakton përpara hedhjes së shortit termat e referencës së kontratës tip dhe tarifën e shpërblimit që do të zbatohet për çdo kontratë.

2. KQZ-ja përzgjedh me short dhe emëron së paku një monitorues për çdo subjekt zgjedhor.

3. Si rregull, shorti hidhet jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të periudhës së monitorimit.

4. Aplikantët kanë të drejtë të jenë të pranishëm në mbledhjen e KQZ-së për hedhjen e shortit. Në rast se janë të pranishëm në hedhjen e shortit, atyre u kërkohet të deklarojnë menjëherë nëse e pranojnë emërimin. Në rast se refuzojnë, përjashtohen nga procedura e mëtejshme e shortit.

5. Vendimi për emërimin, në të cilin përcaktohet dhe afati për dorëzimin e raportit të monitorimit në KQZ, merret jo më vonë se 24 orë nga hedhja e shortit.

Neni 7 Organizimi i shortit

1. Në një enë transparente futen aq gogla sa është edhe numri i ekspertëve pjesëmarrës në short.

2. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letër, ku shënohet emri i ekspertit kontabël pjesëmarrës në short.

3. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore do të tërheqin secili me radhë një gogël nga ena. Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor do të hapë goglën dhe do të lexojë emrin e ekspertit financiar që është shënuar në të. Eksperti financiar, emri i të cilit do të jetë shënuar në



shiritin e letrës, do të jetë eksperti i cili do të monitorojë fushatën zgjedhore të subjektit zgjedhor që tërheq gogllën. Rasti mbahet shënim nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së.

4. Në rast se përfaqësuesi i subjektit zgjedhor nuk është i pranishëm, KQZ-ja cakton një përfaqësues nga stafi për tërheqjen e shortit.

5. Radha e tërheqjes së goglave nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore përcaktohet me parashort, i cili zhvillohet sipas kësaj procedure:

a) Në një enë tjetër transparente futen aq gogla sa është edhe numri i subjekteve zgjedhore që do të auditohen.

b) Në secilën prej goglave futet një shirit letre, ku shënohet emri i një prej subjekteve zgjedhore që do të auditohet.

c) KQZ-ja cakton një person nga stafi për të tërhequr goglat.

d) Personi i caktuar nga stafi i KQZ-së tërheq një gogël, e hap dhe lexon emrin e subjektit zgjedhor që është shënuar në shiritin brenda gogllës dhe ia jep sekretarit të KQZ-së.

e) Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor që është shënuar në shiritin e letrës brenda gogllës së parë do të jetë i pari që do të tërheqë në shortin që do të zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8, pikat 1, 2 dhe 3, kështu do të vazhdohet deri në tërheqjen e të gjitha goglave brenda në enë.

Neni 8

KQZ-ja në çdo rast miraton me vendim rezultatin e shortit.

Neni 9

Ku udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Klement Zguri

UDHËZIM

Nr. 3, datë 2.6.2017

PËR MËNYRËN E PËRLLOGARITJES SË KOSTOS FINANCIARE TË VEPRIMTARIVE, SHËRBIMEVE APO MATERIALEVE QË DO TË PËRDOREN PËR QËLLIME ZGJEDHORE OSE POLITIKE, NGA PARTITË POLITIKE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 23, pika 1, germa b, nenit 24/2, pika 3 e ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë Politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar”,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e përllogaritjes së kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore.

Neni 2

**Kostimi i mallrave apo i shërbimeve të
prokuruar**

1. Përllogaritja e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore bëhet në bazë të çmimit të prokurimit të këtyre mallrave ose shërbimeve.

2. Kostoja financiare vërtetohet nga dokumentacioni fiskal i lëshuar nga furnizuesi i mallit apo i shërbimit.

3. Kur një zgjedhës ofron kohën e tij pa pagesë për të ndihmuar fushatën, atëherë veprimtaria e zgjedhësit do të quhet veprimtari vullnetare dhe nuk do të përfshihet në përllogaritjen e kostos së financimit të veprimtarisë së subjektit zgjedhor.



Neni 3

Dhurimet në natyrë

1. Në rastet kur shërbimet apo mallrat ofrohen pa kosto ose me çmim më të ulët sesa çmimi i të njëjtave shërbime apo mallrave të prokuruar sipas kushteve të tregut, atëherë diferenca midis shumës që subjekti zgjedhor do paguante për mallin ose shërbimin sipas çmimeve të tregut me shumën që paguan faktikisht përbën dhurim në natyrë.

2. Dhurimet në natyrë duhet të regjistrohen nga subjekti zgjedhor sikurse dhurimet në para dhe duhet të përlogariten në koston financiare të veprimtarive, sikur të ishin shërbime apo mallra të prokuruar. Kosto financiare e tyre vërtetohet sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 4 të këtij udhëzimi.

Neni 4

Kostimi i mallrave apo i shërbimeve të dhuruara

1. Përlogaritja e koston financiare të dhurimeve në natyrë bëhet duke u referuar në koston financiare të të njëjtave mallra ose shërbime, në rast se ato prokurohen sipas çmimeve të tregut.

2. Çmimi i tregut për mallra dhe shërbime do të përcaktohet me një nga metodat e mëposhtme:

a) Nëse është e mundur, duke iu referuar indeksit mujor të çmimeve, të publikuara nga INSTAT, në kohën kur mallrat/shërbimet janë ofruar;

b) Nëse furnitori operon në biznesin e ofrimit të këtyre të mirave dhe shërbimeve, çmimi i tregut do të jetë vlera normale tregtare që aplikon furnitori për to; ose

c) Subjekti zgjedhor llogarit çmimin e tregut mbi bazën e mesatares së çmimeve të ofruara nga tre ofrues mallrash/shërbimesh të ngjashme.

3. Kur raporton shpenzimet për veprimtaritë, mallrat apo shërbimet, subjekti zgjedhor është i detyruar të referojë dhe dokumentojë metodën e aplikuar për përlogaritjen sipas këtij neni.

4. Aplikimi i metodës së përlogaritjes jepet në shembujt sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi, të cilët paraqiten për qëllime ilustrimi dhe nuk janë ezaurues.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Klement Zguri

ANEKS

**SHEMBUJ PËR METODËN E
PËRLOGARITJES SIPAS NENIT 3 TË
KËTIJ UDHËZIMI**

Shembull 1

Subjekti zgjedhor A (SZA) kërkon të marrë me qira pajisje audio-vizuale për mitingun e hapjes së fushatës në Tiranë. Shoqëria “Shiko dhe Dëgjo” është ofruar t’i japë pajisjet për këtë organizim me një kosto prej 135,000 lekë. Normalisht, kjo shoqëri do të kërkonte 165,000 lekë për një organizim të tillë, por Administratori i shoqërisë “Shiko dhe Dëgjo” ka dëshirë të mbështesë SZA-në.

Në këtë rast, subjekti zgjedhor SZA duhet të raportojë një dhurim në natyrë prej 30,000 lekë nga shoqëria “Shiko dhe Dëgjo” në raportin e tij, në seksionin 2 (c) të formularit tip, miratuar me vendimin e KQZ-së nr. 167, datë 21.4.2017, “Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standardizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore”. Kjo sepse shuma e zbritjes është më shumë se 10% e çmimit normal.

Shembull 2

Shoqëria “Karrige me mbështetëse” i dhuron kandidatit A 100 karrige për t’i përdorur gjatë takimeve të fushatës për një periudhë dyjavore. Shoqëria normalisht kërkon 75,000 lekë për këtë lloj qiraje. Në qoftë se Kandidati A nuk paguan asgjë, atëherë ky dhurim në natyrë në vlerën 75,000 lekë duhet të regjistrohet. Kandidati A mund t’i referohet INSTAT-it për të parë nëse ka një normë të caktuar. Nëse shoqëria “Karrige me mbështetëse” vetëm shet karrige dhe zakonisht nuk i jep ato me qira, atëherë kandidati duhet të marrë normën e çmimeve nga tri shoqëri që ofrojnë shërbimin e dhënies së karrigeve me qira. Mesatarja e tri ofertave do të raportohet si shuma e dhurimit në natyrë.

Shembull 3

Individi X është një mbështetës i madh i Subjektit Zgjedhor A (SZA) dhe mik i vjetër i kandidatit B, i cili është në listën e kandidatëve të



SZA-së. Individu X i dhuron SZA-së 125,000 lekë. Ai i jep gjithashtu kandidatit B 125,000 lekë dhe 25,000 lekë degës lokale të SZA-së. Gjatë fushatës, individ X shpërndan fletushka te familjet e lagjes së tij në dy raste. Individu X gjithashtu pajton dikë të ndihmojë fushatën me kryerjen e telefonatave. Individu X e paguan këtë person me 40,000 lekë. Së fundmi, individ X i jep kandidatit B të përdorë pa pagesë mjediset e zyrës në ndërtesën e tij tregtare. Normalisht, ai do ta jepte me qira atë hapësirë për 50,000 lekë në muaj.

Kontributi i individit X për fushatën arrin në total vlerën 365,000 lekë. Secili dhurim do duhet të reflektohet në raportin e financimit të fushatës zgjedhore si të ardhura. Përveç kësaj, në formularin tip, miratuar me vendimin e KQZ-së nr. 167, datë 21.4.2017, “Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standardizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore” do të përfshihen automatikisht dhurimet në natyrë, që arrijnë në total 90,000 lekë, si shpenzime të SZA-së.

Shembull 4

Albanian Mega Estate vë në dispozicion të Subjektit Zgjedhor A (SZA) ambiente për zyra elektorale për periudhën një muaj para fillimit të fushatës deri një javë pas përfundimit të zgjedhjeve. Qiraja e zakonshme mujore për këto zyra është 150,000 lekë.

Albanian Mega Estate ka bërë kështu dhurim në natyrë për SZA-në në shumën 350,000 lekë (kosto e qirasë që partia do duhet të paguante për zyrën elektorale sipas çmimit të tregut). Kjo shumë duhet të raportohet në raportin për financimin e fushatës zgjedhore si dhurim në natyrë.

Shembull 5

Albanian Super Financial i jep subjektit zgjedhor A (SZA) hua në shumën 2 milionë lekë me nivel interesi 1%, në vend të nivelit 4% që zbatohet në treg, i pagueshëm pas një viti.

Albanian Super Financial ka bërë kështu dhurim në natyrë në shumën 60,000 lekë

(diferenca midis shumës së pagueshme nga SZA-ja me shumën e pagueshme sipas interesit me vlerën e tregut). Kjo shumë duhet të raportohet si dhurim në natyrë. Huaja është e paligjshme, sepse kapërcen kufirin prej 1 milion lekësh për dhuratat dhe huatë.

Shembull 7

Individu X, mbështetës i SZA-së dhe biznesmen, shpenzon drejtpërdrejt 2 milionë lekë për organizimin e një mitingu elektorale të SZA-së.

Individu X ka bërë kështu një dhurim në natyrë në shumën 2 milionë lekë, me shumën 1 milion lekë si dhurim i paligjshëm.

KËRKESË

Nr. 3350, datë 1.6.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Shtimi i sipërfaqes së varrezave publike Tufinë”, Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 189, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 8 503 936 (tetë milionë e pesëqind e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN
Gjon Radovani



Llogaritjet paraprake për pasuritë që preken nga zgjerimi i sipërfaqeve të varrezave publike Tufinë

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona Kadast.	Nr. Pasurisë	Sip. Përgj. Tokë Bujqësore (m ²)	Sip. Tokë Bujqësore e prekur (m ²)	Çmimi Tokë Bujqësore lek/m ²	Vlera në lekë	Konfirmim i ZVRPP- Tiranë
1	Petrit Shyqyri Qefalia	"Arë"	3426	27/6	2900	2900	448	1,299,200	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
2	Bashkim Mexhid Kuka	"Arë"	3426	27/5	2500	2500	448	1,120,000	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
3	Qemal Abdulla Qefalia	"Arë"	3426	27/4	5200	5200	448	2,329,600	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
4	Shtet	"Arë"	3426	619	500	299	448	0	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
5	Shtet	"Arë"	3426	615	200	200	448	0	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
6	Shtet	"Arë"	3426	27/11	200	200	448	0	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
7	Qemal Abdulla Qefalia	"Arë"	3426	27/10	1770	1770	448	792,960	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
8	Qemal Abdulla Qefalia	"Arë"	3426	27/8	810	810	448	362,880	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
9	Shtet	"Arë"	3426	27/9	720	720	448	0	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
10	Dilaver Islam Dajti	"Arë"	3426	28	3000	2272	448	1,017,856	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
11	Petrit Shyqyri Qefalia	"Arë"	3426	27/2	3000	3000	448	1,344,000	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
12	Ramiz Osman Qefalia	"Arë"	3426	27/1	530	530	448	237,440	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
Total						20401		8,503,936	

1. Për tokën bujqësore, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresën e ZVRPP, Tiranë, nr.prot. 35393/1, datë 13.01.2017, protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. prot. 1486, dt. 13.01.2017.

KËRKESË

Nr. 906/6, datë 6.6.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemi dhe ndriçim Rruga e Malit, Rruga Kalaja" në bashkinë Krujë.

Subjekti kërkues është bashkia Krujë. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të

pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 247 479 (dyqind e dyzet e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË
BRENDSHME
Rovena Voda

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për objektin:

"Sistemi dhe ndriçim rruga e malit, rruga Kalaja"

NR.	EMËR	MBIEMËR	Zona Kad.	NR. Pas.	Siperf. Pergj. m ²	Siperf. Prekur m ²	Çmimi per m ²	Vlefte ne lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Krujë
1	Seit	Llubani	8621	6/266	214	25.5	4011	102,281	Konfirmimi i ZVRPP, Krujë
2	Bukurije	Llubani	8621	6/267	117.5	15	4011	60,165	Konfirmimi i ZVRPP, Krujë
3	Shpend	Llubani	8621	6/200	146	21.2	4011	85,033	Konfirmimi i ZVRPP, Krujë
Total								247,479	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 112 lekë